



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

0Numri i lëndës: 2022:096998
Datë: 22.11.2024
Numri i dokumentit: 06495480

C.nr. 2115/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Florian Krasniqi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses L.Th., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat Xh.S., nga Prishtina, kundër të paditurës T.i K. Sh.a, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti: kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të punës, shpërblimit jubilar dhe shtesës prej 0.5% të përvojës së punës, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik, në prani të përfaqësuesit të paditësve dhe përfaqësuesit të të paditurës, me datë 22.11.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses L.Th. kundër të paditurës T. i K.

II. DETYROHET e paditura T.i K. që paditëses t'ia paguaj shumat si në vijim:

- Në emër të shpërblimit jubilar, për 10 vite përvojë të punës, t'ia paguaj shumën prej 1,246.00 euro;
- Në emër të shujtave ditore – shpenzimeve të ushqimit, për periudhën 01.06.2019 deri me datë 31.05.2022, për gjithsejtë 324 ditë të punës, t'ia paguaj shumën prej: 972.00 euro;
- Në emër të shtesës në pagë prej 0.5% për çdo vit të përvojës së punës, për periudhën 01.06.2019 deri me datë 31.05.2022, t'ia paguaj shumat si në vijim: shumën neto prej 1,305.27, në emër të trustit pensional për punëdhënësin dhe punëmarrësin shumën prej 75.03 euro dhe në emër të tatimit në të ardhura personale që duhet të paguhet në dobi të buxhetit të Republikës së Kosovës, shumën prej 120.36 euro.

III. DETYROHET e paditura T. i K. që paditëses shumat si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi tua paguajë me kamatë ligjore prej 8% në vit, e cila do të llogaritet nga data 01.01.2021 e deri me datë 10.06.2024, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 574.00 euro, të gjitha këto brenda afatit prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses me të cilën ka

kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses në emër të shujtave ditore dhe shtesës prej 0.5% në bazë të përvojës së punës, për periudhën 01.06.2022 deri me 31.12.2023, t'ia paguajë shumën prej 4,025.68 euro.

A r s y e t i m

I. Padia dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësja pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi me objekt të kontestit kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, shpërblimit jubilar dhe shtesës prej 0.5% mbi përvojën e punës në pagën bazë. Në padi ndër të tjera ka theksuar se, paditësja është e punësuar tek e paditura T. i K., me kontratë të rregullt nga data 16.09.2009 duke krijuar marrëdhënie të rregullt të punës sipas nenit 19 të Ligjit të Punës. Përgjatë seancave ka theksuar se e paditura edhe pse e ka pasur detyrim ligjor t'ia paguaj shujtat dhe pagën jubilarë sipas marrëveshjes kolektive të federatës së punëtorëve i ka shkelur këto detyrime duke i shkaktuar dëme materiale paditëses e që kjo është vërtetuar edhe me ekspertizën financiare. Andaj i ka propozuar gjykatës që padinë ta aprovoj në tërësi si në precizimin e datës 25.09.2024

E paditura me përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve me arsyetimin se, pagat jubilarë nuk janë kategori ligjore dhe mbi këtë bazë nuk është as e detyrueshme që të paguhet, sepse të njëjtat janë të kushtëzuara me plotësimin e kushteve të përcaktuara me marrëveshjen mes sindikatës dhe punëdhënësit dhe me performancën pozitive të punëdhënësit, ndërsa në rastin konkret e paditura ka provuar dhe dëshmuar me pasqyra financiare se e paditura që nga vitit 2018 e tutje ka afaruar me humbje milionëshe dhe ka pengesa edhe për pagesën e pagave të rregullta mujore. Ka shtuar se, që nga viti 2005 e deri më tani sistemi i pagave realizohet konform marrëveshjes së vitit 2005, nr. 663/01 e datës 15 shkurt 2005 dhe aneksit të kësaj marrëveshje të vitit 2010 e cila marrëveshje është ende në fuqi nga çka rezulton se kërkesa e paditësve është edhe e pasafatshme dhe e pabazuar. Ka shtuar se në Kontratën Kolektive të T.të K., të vitit 2019, mundësia e pagesës së beneficioneve të tilla është e lidhur me marrëveshjen PTK-Sindikata e vitit 2005, që nënkupton se kushti primar është që objektivist e paditura T. i K. të operojë me performancë pozitive financiare. Tutje ka theksuar se edhe në mbështetje të dispozitave ligjore, rezulton se kërkesëpadia e paditëses për kompensimin e shpërblimit jubilar, shujtave dhe përvojës së punës është e parashkruar konform dispozitave të LMD-së. Me rregulloren e punës së T.të K., në nenin 38 të kësaj rregulloreje është përcaktuar se T. i K. do të paguajë shtesën mbi përvojën e punës, si dhe shujtat ditore sipas performancë pozitive financiare të T.të K. Ka theksuar se bazuar, paditësja padinë e ka ushtuar pas kalimit të validitetit të Marrëveshjes Kolektive e që thirrja e paditëses në këtë dokument është tërësisht e pavend dhe pa bazë ligjore.

Gjykata ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe me propozimin e palëve ndërgjyqëse ka administruar provat si në vijim: vendimi me Nr.1946/21 i datës 06.07.2021, lista e pagave janar 2022, lista e pagave shkurt 2022, lista e pagave mars 2022, aktvendimi i datës 12.06.2021, kontrata e punës me Nr.01-4145/229/2015 e datës 02.09.2015, ekspertiza financiare e datës

07.06.2024, marrëveshje PTK-Sindikata e datës 15.02.2005, raporti i auditimit për pasqyrat financiare i vitit 2020, pasqyrat financiare për periudhën që ka përfunduar me 31.12.2019.

Nga deklaratimet e palëve në padi, përgjigje në padi dhe seanca gjyqësore, rezulton se ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësja ka themeluar marrëdhënie pune me këtu të paditurën.

Kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse mbeten faktet nëse për paditësen është krijuar baza ligjore dhe të njëjtës iu ka lindur e drejta për realizimin e shpërblimit jubilar, shujtave ditore për ditët e punës dhe kompensimin e shtesës prej 0.5 për përvojën e punës.

- *Kompensimi lidhur me shpërblimin – pagën jubilarë*

Lidhur me pretendimet e paditësve sa i përket kësaj çështje kontestimore, gjykata fillimisht thekson se faktin se këtu e paditura me datë 31.05.2019 ka nënshkruar Marrëveshjen Kolektive të Punës në T.e K., marrëveshja me numër 01-3207/19, marrëveshje kjo e nënshkruar nga e paditura me federatën sindikale të punëtorëve në T.e K. e cila ka qenë në fuqi nga data 01.06.2019 deri me datë 31.05.2022.

Me nenin 44 paragrafi 4 të marrëveshjes kolektive të punës në T. e K., të datës 31.05.2019 është përcaktuar: *Punonjësve u takojnë shpërblimet jubilarë për 10 vite përvojë pune pandërprerë tek punëdhënësi i fundit 1 pagë mujore të tij, 20 vite të përvojës së pandërprerë në vlerë të 2 pagave mujore të tij dhe për 30 vite të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të 3 pagave mujore të tij. Po ashtu me nenin 38, paragrafi 8 të rregullores për marrëdhënie pune në Te.e K. përcaktohet se: për çdo dhjetë (10) vite të punës së pandërprerë në TK të punësuarit i jepet pagesë jubilarë në lartësi të një page të fundit të punëtorit, ndërsa me nenin 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës përcaktohet se: I punësuarit, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij; 1.2.për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; 1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. 2.Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. 3.Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf.*

Nga dispozitat e lartë cituara të Marrëveshjes Kolektive dhe rregullores së lartëcituar, rezulton se në mënyrë obligative është përcaktuar detyrimi që e paditura punëmarrësve të saj të iu paguajë pagën jubilarë varësisht nga vitet e përvojës së punës, ndërsa fakti që paditësve nuk iu janë paguar pagat jubilarë përkundër arritjes së vitit jubilar, është pohuar edhe nga e paditura përmes përgjigjes në padi dhe përgjatë seancave gjyqësore, ngase e paditura e ka kontestuar detyrimin e saj për pagesën e pagave jubilarë.

Bazuar në karakterin obligativ të dispozitave të lartë cituara të marrëveshjes kolektive të punës në T.e K., gjykata vlerëson se për paditësit është krijuar e drejta për të kërkuar realizimin e

shpërblimit jubilar.

Sa i përket kushtit për realizimin e shpërblimit jubilar, gjykata gjen se paditësja Lumnije Thaçi ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën në muajin dhjetor 2009 fakt ky i cili nuk është pohuar as nga e paditura, por që vërtetohet edhe me listën e trustit pensional nga ku shihet se nga muaji dhjetor 2009 ka filluar pagesa e trustit pensional nga e paditura për paditësen. Meqenëse paditësja ka filluar punën tek e paditura në vitin 2009, rezulton se e njëjta vitin e dhjetë jubilar e ka arritur në vitin 2019, përkatësisht në muajin dhjetor 2019 pra gjatë kohës sa ka qenë në vlefshmëri marrëveshja kolektive e punës në T. e K.

Lartësinë e pagës bazë për paditësit gjykata e vërtetoj bazuar në ekspertizën financiare, ku ekspertja ka marrë konfirmimin se në kohën kur paditësja ka arritur vitin e dhjetë jubilar ka pasur pagën bazë në shumën prej 1,246.00 euro.

Bazuar në këto konstatime, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi sa i përket detyrimit të të paditurës që paditëses t'ia paguaj pagën jubilarë në shumën si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

- *Kompensimi lidhur me shpenzimet e ushqimit për ditët e punës.*

Sa i përket kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, gjykata sjell në vëmendje dispozitën e nenit 44 paragraf 3 të marrëveshjes kolektive të punës në T.e K. e cila përcakton se: *punonjësve iu njihet e drejta e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për një ditë pune prej 3 euro. Po ashtu me nenin 38, paragrafi 7 të Rregullores së Punës në T.e K., e datës 29.11.2019, është përcaktuar se të punësuarve ju njihet e drejta e shtesës për përvojë të punës prej 0.5% të pagës bazë, për çdo vit të plotë të përvojës në punë si dhe shujta ditore e përcaktuar me kontratën kolektive.*

Nga dispozitat në fjalë po ashtu derivon obligimi i të paditurës që punëtorëve të saj tua paguajë shpenzimet e ushqimit, ndërsa fakti se paditësve nuk iu janë paguar shpenzimet e ushqimit është pohuar po ashtu nga e paditura në përgjigje në padi dhe seanca gjyqësore ngase të njëjtit e kanë kontestuar kërkesën e paditësve se të njëjtëve iu takojnë shpenzimet e ushqimit. Marrë parasysh faktin se nga dispozita e lartëcituar derivon obligimi i të paditurës për pagesën e shpenzimeve të ushqimit, gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke detyruar të paditurën për pagesën e shpenzimeve të ushqimit për paditësit.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadsisë lidhur me këtë bazë, gjykata me propozimin e përfaqësuesit të paditëses ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare, ku gjykata me rastin e aprovimit të propozimit për ekspertizë financiare ka detyruar të paditurën që ekspertës financiare ti mundësojë qasje në regjistrat e hyrje daljeve të punëtorëve, dhe nga këto lista – evidenca ekspertja financiare ka bërë nxjerrjen e numrit të ditëve që paditësja ka punuar për periudhën nga data 01.01.2021 e deri me datë 31.05.2022. Për këtë periudhë paditësja ka qenë prezentë në vendin e punës për gjithsejtë 324 ditë të punës, andaj llogaritja është bërë në atë formë që numri i ditëve të punës është shumëzuar me tre euro për një ditë pune dhe ka

rezultuar shuma prej: 972.00 euro (324 x 3 = 972.00 euro).

Lidhur me këtë pjesë të llogaritjes, gjykata ekspertizën e gjeti si të besueshme e profesionale, ngase numri i ditëve të punës për periudhën kontestuese për paditëses është marrë në bazë të listave – evidencave të të paditurës, e që sipas ekspertes financiare këto lista i janë prezantuar të njëjtës nga personat kompetent tek e paditura.

- *Kompensimi lidhur me shtesën prej 0.5% mbi pagën bazë*

Sa i përket shtesës mbi pagën bazë në vlerë prej 0.5% për çdo vit të përvojës së punës, gjykata iu referua bazës ligjore përkatëse, gjegjësisht nenit 44 paragrafi 2 të marrëveshjes kolektive të punës në T.e K., në të cilën dispozitë është përcaktuar se: *punonjësve u takon kompensimi i shtesave për përvojë pune, 0.5% të pagës bazë, për çdo vit të plotë të përvojës së punës. Po ashtu me dispozitën e nenit 38, paragrafi 7 Rregullores së punës në T.e K. e datës 29.11.2019, e cila ka përcaktuar se: të punësuarve ju njihet e drejta e shtesës për përvojë të punës prej 0.5% të pagës bazë, për çdo vit të plotë të përvojës në punë si dhe shujta ditore e përcaktuar me kontratën kolektive.*

Nga dispozitat e lartë cituara vihet në interpretimin se edhe marrëveshja kolektive e të paditurës dhe rregullorja e punës e të paditurës kanë përcaktuar të drejtën e të punësuarve – këtu paditësve – që të iu paguhet shtesa prej 0.5 % për çdo vit të përvojës së punës dhe e paditura nuk ka ofruar prova që shtesa e tillë iu është paguar të njëjtëve.

Mbi këtë bazë, gjykata ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare, ku nga ekspertja në bazë të vërtetimeve mbi përvojën e punës të bashkëngjitur nga paditësja është llogaritur se: shtesa prej 0.5% për çdo vit të përvojës së punës për periudhën nga data 01.01.2021 deri me datë 31.05.2022 është shumën neto prej 1,305.27, në emër të trustit pensional për punëdhënësin dhe punëmarrësin shumën prej 75.03 euro dhe në emër të tatimit në të ardhura personale që duhet të paguhet në dobi të buxhetit të Republikës së Kosovës, shumën prej 120.36 euro.

Nga të gjitha të lartë cituarat gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

- *Pjesa e refuzuar e kërkesëpadisë*

Gjykata ka vendosur si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke refuzuar shumat e kërkuara përtej lartësisë së shumave të aprovuara si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kërkesës së shujtave ditore, gjykata në pikën III të dispozitivit ka refuzuar shumat e kërkuara përtej shumave të aprovuara si në pikën II të dispozitivit, kjo për faktin se me nenin 4, paragrafi 1 të Marrëveshjes Kolektive të Punës në T. e K., është përcaktuar se: *kjo marrëveshje lidhet në afat prej 3-tre viteve duke filluar nga data 01.06.2019 deri me datë 31.05.2022, ndërsa në paragrafin 2 të kësaj marrëveshje është përcaktuar se: palët pajtohen që me mbarimin e afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, vlefshmëria e kësaj*

marrëveshja zgjatet deri në lidhjen e marrëveshjes së re duke ruajtur kushtet ekzistuese ose duke parashikuar kushte të reja. Nga interpretimi i dispozitave të kontratës, shihet se palët, pra këtu e paditura dhe sindikata e punëtorëve në T. e K. janë dakorduar që kontrata të lidhet për një periudhë prej tre vitesh dhe kanë paraparë mundësinë që vlefshmëria e kontratës të zgjatet deri në lidhjen e marrëveshjes së re duke ruajtur kushtet ekzistuese. Në këtë situatë gjykata sjell në vëmendje nenin 90 paragrafi 4 të Ligjit të Punës i cili përcakton se *Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet si dhe Neni 4 i Ligjit të Punës i cili përcakton se: 1. Dispozitat e Kontratës Kolektive, Aktit të Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratës së Punës duhet të jenë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.* Nga dispozitat e ligjit të punës, shihet se kontrata kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar por jo më të gjatë se sa tre vite dhe se dispozitat e kontratës së punës nuk mund të jenë në kundërshtim me ligjin e punës, çka rezulton se dispozita e nenit 4 të marrëveshjes kolektive të punës në T.e K. është në kundërshtim me ligjin e punës andaj një dispozitë e tillë nuk mund të ketë për pasojë edhe zgjatjen në heshtje të afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kolektive të punës në T. e K. në të cilën paditësit e kanë bazuar kërkesën e tyre.

Për më tepër edhe në nenin 38, paragrafi 7 të rregullores së punës është përcaktuar se punonjësve ju njihen shpenzimet e ushqimit *e përcaktuar me kontratën kolektive*, pra vet dispozita e rregullores së punës kompensimin e shujtave ditore ka kushtëzuar me marrëveshjen kolektive të punës në T.e K.

Po ashtu edhe sa i përket shtesës prej 0.5%, gjykata ka refuzuar shumën e kërkuar nga data 01.06.2022 deri me datë 31.12.2023, kjo për shkak të skadimit të vlefshmërisë së Kontratës Kolektive të punës në T.e K. Për më tepër gjykata vlerëson se sa i përket shtesës prej 0.5%, një e drejtë e tillë pas datës 01.06.2022 nuk derivon as nga rregullorja e punës e datës 29.11.2019, kjo për faktin se edhe rregullorja e punës e datës 29.11.2019 është ndryshuar me rregulloren numër 01-2978-22 e datës 27.06.2022, nga e cila shihet se shtesa prej 0.5% nuk është njohur për punonjësit e të paditurës.

Andaj gjykata sa i përket kërkesës së shpenzimeve të ushqimit dhe shtesës prej 0.5% ka refuzuar shumën prej 4,025.68 euro, për periudhën 01.06.2022 deri me datë 31.12.2024.

Me rastin e vendosjes gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera të të paditurës por që të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendosje ndryshe. E paditura ka pretenduar se padia e paditësve është e pas afatshme ngase është paraqitur jashtë afatit prej 30-tridhjetë ditëve por që sipas vlerësimit të kësaj gjykate një pretendim i tillë është i pabazuar, kjo për faktin se kërkesa e paditësve ka të bëjë me kërkesa monetare, detyrime këto për të cilat nuk aplikohen dispozitat e nenit 78 dhe 79 të Ligjit të Punës dhe një kërkesë e tillë nuk është e lidhur me afat për paraqitjen e padisë.

E paditura po ashtu ka pretenduar se përmbushja e detyrimeve të tilla është e kushtëzuar me performancën pozitive financiare të të paditurës, megjithatë gjykata gjen se kërkesa e paditësve gjen mbështetje në dispozitat e marrëveshjes së përgjithshme të punës në T.e K. dhe

të rregullores së punës, ashtu që në Marrëveshjen Kolektive të Punës në T. e K. gjejjësisht nenit 44 të të njëjtës marrëveshje obligimi i përmbushjes së këtyre detyrimeve nga e paditura nuk është kushtëzuar me performancën pozitive financiare, andaj paditësit shumat e njohura sa i përket shpërblimit jubilar dhe shujtave iu njihen sipas nenit 44 të Kontratës Kolektive të Punës, nenin 44 të të njëjtës, e cila dispozitë përmbushjen e detyrimeve të shujtave dhe pagave jubilarë nuk e ka kushtëzuar me performancën pozitive financiare të të paditurës, por që e paditura me nënshkrimin e marrëveshjes kolektive ka marrë obligimin që krahas pagës bazë tua paguajë punëtorëve edhe shtesat, përfshirë pagën jubilarë, shpenzimet e ushqimit dhe shtesën prej 0.5% për çdo vit të përvojës së punës.

Tutje, e paditura ka pretenduar se mundësia e pagesës së beneficioneve të tilla është e lidhur me marrëveshjen PTK-Sindikatë e vitit 2005 dhe aneksin e saj të vitit 2010, megjithatë sa i përket këtij pretendimi gjykata, i referohet nenit 54 paragrafi 2 të marrëveshjes kolektive të punës në T. e K. e cila përcakton se: *Zbatimi i marrëveshjes TK- Sindikatë për pagat dhe ndarjet e bonusit Nr. 663/01 e datës 15.02.2005 dhe aneksi i kësaj marrëveshje të vitit 2010 si dhe sigurimi shëndetësor i punëtorëve, garantohen nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje për periudhën e vlefshmërisë në fjalë.* Nga dispozita e tillë e marrëveshjes kolektive në T. e K. shihet se pagesa e shujtave, pagave jubilarë dhe shtesës për përvojën e punës nuk është e kushtëzuar domosdoshmërisht me marrëveshjen TK-Sindikatë të vitit 2005 dhe as me aneksin e saj të vitit 2010, por që palët janë dakorduar që të garantohet edhe zbatimi marrëveshjes së vitit 2005 dhe aneksit të saj të vitit 2010.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera të të paditurës, megjithatë të njëjtat i gjeti pa ndikim në një vendosje ndryshe.

Lidhur me kamatën ligjore prej 8% në vit, e cila do të aplikohet mbi shumat e aprovuara si në pikën II të dispozitivit, Gjykata ka vendosur konform nenit 382 par.1 lidhur me par.2 të LMD-së, duke e obliguar të paditurën që shumën e gjykuar në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ua paguajë së bashku me kamatën ligjore prej 8% e cila do të llogaritet nga data 01.01.2021 deri me datë 10.06.2024 sipas kërkesës së palës paditëse.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore, gjykata detyroj të paditurën që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore, kjo duke u bazuar në nenin 450 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, duke përfshirë shpenzimet e domosdoshme të krijuara gjatë procedurës gjyqësore, dhe atë: në emër të përpilimit të padisë shumën prej 104 euro, përfaqësimi në dy seanca gjyqësore në shumën prej euro 270 (135 euro për secilën seancë), për ekspertizë financiare shumën prej 200 euro, e në total vlera e shpenzimeve të procedurës kontestimore në shumën prej 574 euro ndërsa ka refuzuar shumën përtej kërkesës bazuar në rregulloren për tarifat e avokateve.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, bazuar në nenin 160 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.2115/2022, datë 22.11.2024

Gjyqtari
Florian Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimet të këtij aktgjykimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.